



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



## RAPORT I VEÇANTË MONITORIMI TEMATIK

**GJETJET DHE REKOMANDIMET PAS  
REALIZIMIT TË MISIONIT MONITORUES  
NË IEVP “ALI DEMI” (325) MBI  
AKOMODIMIN E SHTETASEVE NËN MASË  
MJEKËSORE DHE MASË SIGURIMI  
SHTRIM I PËRKOHSHËM NË NJË SPITAL  
PSIKIATRIK, GJATË PERIUDHËS SË  
PANDEMISË GLOBALE COVID-19**

Mbështetur financiarisht nga:



*Ky raport i veçantë monitorimi tematik realizohet në kuadër të projektit “Të drejtat e personave të privuar nga liria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore”, të mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.*



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## RAPORT I VEÇANTË

### MISION MONITORIMI TEMATIK

#### INSTITUCIONI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE “ALI DEMI” (325)

**Data e misionit: 14 Tetor 2020**

#### *Përmbledhje ekzekutive*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në funksion të misionit të tij për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve gjatë periudhës së pandemisë globale Covid-19, më datë 14 Tetor 2020 realizoi mision monitorimi tematik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) “Ali Demi” (325). Ky mision u ndërмор nga vëzhguesit e KShH-së, në bashkëpunim me ndihmës-komisionerët e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor funksional pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë kësaj vizite monitoruese u vërejt me shqetësim akomodimi i shtetaseve ndaj të cilave Gjykata ka caktuar masë mjekësore, bazuar në nenin 46 të Kodit Penal dhe masë sigurimi “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” siç përcaktohet në nenin 239 të Kodit të Procedurës Penale. Në mungesë të ngritjes së institucionit të posaçëm mjekësor dhe mos rakordimit ndërmjet institucioneve publike për vendosjen e këtyre shtetaseve në spitalet civile psikiatrike, në shkelje të kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar këto shtetase vijnë të mbahen të akomoduara në institucionet e sistemit penitenciar. Krahas kushteve infrastrukturore të amortizuara, u vërejt cënim i trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe psiko-social, duke e kushtëzuar akomodimin e këtyre kategorive në sistemin e burgjeve në një trajtim të mirëfilltë farmakologjik.

\*\*\*\*\*

Vëzhguesit morën takim me Drejtorin e institucionit, përfaqësues të sektorit të kujdesit shëndetësor, përfaqësues të sektorëve juridikë dhe psiko-socialë, si dhe u mor takim me shtetase të paraburgosura/dënuara e kategorinë e shtetaseve me masë mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion të posaçëm mjekësor” dhe masë sigurimi personal “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, ndërkohë që u verifikuan kushtet në të cilat ata po vuanin dënimin. Gjithashtu, vëzhguesit verifikuan regjistra dhe praktika të mbajtura nga ana e stafeve përgjegjëse të sektorëve të IEVP ‘Ali Demi’ (325).

Nëpërmjet këtij raporti të veçantë, vlerësojmë adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve konkrete, me synim marrjen e masave për garantimin e të drejtave dhe lirive të shtetaseve të akomoduara në këtë institucion:



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. Gjatë momentit të monitorimit, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se prej datës 24 Prill 2020, 22 shtetase ndaj 19 prej të cilave Gjykata kishte vendosur masë mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor” dhe 3 shtetase po ekzekutonin masën e sigurisë “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, qëndronin të akomoduar në IEVP ‘Ali Demi’ (325).

*Në kontekstin infrastrukturor, akomodimi i kategorisë së këtyre shtetaseve, realizohej në 1 dhomë, e ndarë në dy pjesë me zgarë metalike në të cilën gjenden 16 shtretër, respektivisht 8 në njërin anë dhe 8 në anën tjetër, ndërkohë në një dhomë tjetër ku ishin akomoduar 4 shtetase me masë mjekësore mjekim të detyruar, nuk kishte dritare dhe ndriçim natyral. Këto ambiente ashtu sikurse edhe pjesa tjetër e godinave karakterizoheshin nga lagështirë tepër e lartë, por gjithashtu edhe dëmtime infrastrukturale të shkaktuara nga tërmeti. Ndërkohë çatia e institucionit nuk ofron hidroizolim dhe në disa pjesë të murit, shtresa e suvasë ishte rrëzuar apo ishte pranë rrëzimit, cka vendos potencialisht në rrezik, jetën/shëndetin e kësaj kategorie.*

Duke marrë parasysh, prevalencën e marrjes së masave për garantimin e higjenes personale dhe respektimin e protokolleve mjekësore me qëllim parandalimin e virusit Covid Sars-2, në ambientin kaponon ku ishin të vendosura 16 shtetase me masë mjekësore dhe masë sigurimi shtrim i përkohshëm u vërejt qëndrimi i tyre në grup. Kjo formë akomodimi krijonte pasiguri dhe shqetësim për vetë këtë kategori shtetasësh, të cilat vuanin nga sëmundje të ndryshme të shëndetit mendor, ku vlen të theksohet se forma dhe stadi i tyre ishte i ndryshëm, si dhe përbën cënim të nenit 32 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

**KShH konstaton se akomodimi i këtyre kategorive në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me nenin 46 të Kodit Penal, nenin 239 të Kodit të Procedurës Penale dhe me nenin 15 pika 2 të Ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.**

**Vlerësojmë se pavarësisht se transferimi i këtyre shtetaseve nga IVSHB në IEVP Ali Demi dhe anasjelltas, të dy këto institucione të sistemit penitenciar, u kushtëzua për shkak të pandemisë Covid-19, vëzhguesit e KShH-së, pas monitorimit të kujdesshëm të kushteve dhe trajtimit të kësaj kategorie shtetasësh vlerësojnë se një vendimmarrje e tillë ka qenë e nxituar nuk është shoqëruar me asnjë studim sado modest paraprak, për të identifikuar faktorët përcaktues që do të ndikonin në gjendjen e tyre dhe si përfundim, situata e krijuar, ka sjellë cënimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të tyre. KShH ka sugjeruar marrjen e masave konkrete për shmangien e praktikave të tilla të nxituara dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.**

2. U konstatua me shqetësim se transferimi i këtyre shtetaseve nuk ishte shoqëruar me komandimin e stafit mjekësor shtesë dhe as nuk është shoqëruar me trajnimin e stafit civil ose me uniformë, aktual të IEVP Ali Demi, çka ka rezultuar në 2 raste me dëmtime fizike të punonjësve të sigurisë për shkak të sulmeve ndaj tyre. U evidentua mungesa e një mjeku psikiatër në IEVP ‘Ali Demi’ (325), për shkak të mungesës së akomodimit të shtetaseve të paraburgosura/dënuara të diagnostikuara me çrregullime të shëndetit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mendor. Gjatë periudhës rreth 7 mujore të akomodimit të këtyre kategorive të shtetaseve në IEVP “Ali Demi”, ky funksion është mbuluar nga një mjek psikiatër i IVSHB-së, i cili megjithëse kryente vizita periodike në institucion, ato ishin të shkëputura në kohë, pra nuk ishin të shpeshta. Nga ana e stafit institucional ishte kërkuar që mjeku psikiatër të vinte për vizita dy herë në javë në institucion por edhe kjo, nuk rezultoi e arritur, pasi nga verifikimi i dosjeve përkatëse shëndetësore, vërehej mungesë e ndjekjes së ekzaminimeve/rekomandimeve mjekësore periodike.

**Duke marrë parasysh faktin se funksioni i mjekut psikiatër nuk është parashikuar në organikën institucionale, KShH sugjeron se gjatë periudhës së akomodimit të këtyre shtetaseve në IEVP ‘Ali Demi’ (325) mund të aplikohet procedura e transferimit të përkohshëm të një mjeku të këtij profili, i cili do të ishte i atashuar me kohë të plotë në këtë institucion, për të përmbushur nevojat kryesore që do të dilnin nga trajtimi mjekësor i këtyrë pacienteve.**

**Kushtet në të cilat ju është ofruar kujdesi shëndetësor këtyre shtetaseve, gjatë periudhës së pandemisë globale Covid-19, në mungesë të trajtimit të individualizuar mjekësor dhe periodik përbëjnë cenim të nenit 102 pika 1 dhe 104 pika 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve si dhe shkelje të nenit 42 pika 2 Ligji nr. 81/2020.**

**Mungesë e ndjekjes periodike të gjendjes mendore dhe shëndetësore të këtyre shtetasve konstatohet edhe nga shënimet e realizuara nga stafi shëndetësor i IVSHB. Praktikant e verifikuara rishtazi në IEVP reflektojnë të dhëna mbi ekzaminimet me mjekun psikiatër në një diferencë 1-2 muaj nga njëra tjetra, duke cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë aksesin efektiv të këtyre shtetaseve në kujdesin shëndetësor.**

3. Pas njohjes me dosjet psiko-sociale dhe bashkëbisedimin me përfaqësueset e sektorit psiko-social u konstatua se rezultonte i munguar trajtimi psiko-social në formën e aktiviteteve rekreative dhe rehabilituese siç është parashikuar nga standardet e KPT-së, me qëllim shmangien e ofrimit të trajtimit të vetëm farmakologjik, për shtetaset ndaj të cilëve Gjykata ka vendosur masë mjekësore dhe masë sigurimi personal shtrim i përkohshëm. Për shkak të kufizimeve të lidhura me çështjet e sigurisë, këto shtetase nuk mund të asistoheshin me këshillim individual në dhomën e dedikuar për takimin me të paraburgosurat, ndërkohë që kjo terapi sipas stafit realizohej gjatë kohës së ajrimit, ku një mungesë e tillë sjell shkelje të rëndë të parashikimeve dhe qëllimit të nenit 14 pika 2 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

**KShH ka sugjeruar marrjen e masave konkrete për shmangien e praktikave të dokumentimit në blloqe personale të këshillimeve individuale apo metodikës së përdorur për zbatimin e planit të individualizuar për trajtimin psiko-social të shtetaseve të akomoduar në IEVP 325, nëpërmjet përdorimit të një gjuhe të përgjithshme dhe formale. Kjo praktikë e cila e bën të pamundur ndjekjen konsistente dhe periodike në kohë të këtij plani, bie ndesh me nenet 12, 13 dhe 14 të ligjit nr. 81/2020 dhe 23 e 56 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

4. KShH evidentoi rastin e një shtetaseje e cila qëndronte e akomoduar në I EVP 325 me qëllim ekzekutimin e masës së sigurimit të përcaktuar në nenin 239 K.Pr.Penale. Gjatë qëndrimit në këtë I EVP rezultoi se kjo shtetase është diagnostikuar me Covid-19, por nga njohja me dosjen personale shëndetësore nuk dokumentohej procedura e ndërmarrë në momentin e identifikimit, diagnostikimit fillestar dhe trajtimit në momentin e rikthimit në I EVP. U konstatua prezenca e fletëdaljes e lëshuar nga QSUT Infektiv.

**KShH rekomandon marrjen e masave konkrete për evidentimin nga ana e stafit shëndetësor të procedurës së ndërmarrë nga momenti i diagnostikimit deri në negativizimin e shtetasve të prekur nga Covid Sars-2. Kjo formë e trajtimit të individualizuar dhe periodik do të mundësonte respektimin e neneve 41 dhe 42 të ligjit nr. 81/2020 dhe nenet 15, 23 pika 7 gërma dh), 102 e vijues të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe standardeve të KPT-së të cilat parashikojnë dokumentimin e çdo informacioni diagnostikues.**

5. Edhe pse në një mase të madhe të braktisura nga ana e familjarëve të tyre, shtetasit e vendosura nën masë mjekësore dhe masë sigurimi personal ‘shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik’ referuan ankesa mbi pamundësinë e realizimit të takimeve fizike me familjarët. Vlerësojmë se masa e kufizimit absolut të realizimit të takimeve fizike duhet rishikuar në raport me faktin se kemi të bëjmë me subjekte vulnerabël të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë. Sipas Standardeve Minimum të Trajtimit të të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës) të Kombeve të Bashkuara kanë parashikuar kërkesën për kufizimin e lëvizjes së të burgosurve për 22 orë ose më shumë në ditë pa një kontakt domethënës njerëzor me një masë të jashtëzakonshme, dhe asnjëherë përtej një maksimumi prej 15 ditësh radhazi (izolim i veçuar i zgjatur). Por në çdo rast, këto standarde kanë parashikuar mundësinë e abstenimit nga pezullimi në mënyrë absolute i kontakteve me familjarët.<sup>1</sup>

**KShH sugjeron rishikimin e masave të kufizimit absolut të vendosura në marrëdhëniet ndërmjet të burgosurve dhe familjarëve të tyre, në raport me kufizimet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. KShH rekomandon mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve alternative me qëllim realizimin e kontakteve fizike ndërmjet të burgosurve dhe familjarëve (duke respektuar protokollet anti-Covid19, si ruajtja e distancimit social, realizimi i takimeve nëpërmjet një xhami ndarës, si dhe përdorimi i maskave dhe dorezave për pjesëmarrësit në takim), sipas një planifikimi të caktuar kohor dhe ditor, duke i dhënë prevalencë lidhjeve të afërta gjinore.**

Me anë të këtij raporti, pas vënies në dijeni të procesit të transferimit të shtetasve ndaj të cilave Gjykata ka caktuar masë mjekësore sipas nenit 46 të Kodit Penal dhe masë sigurimi shtrim i përkohshëm referuar nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, nga I EVP ‘Ali Demi’ (325) në IVSHB, vlerësojmë se gjetjet e konstatuara me shqetësim gjatë vizitës monitoruese

---

<sup>1</sup> [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/UNODC\\_Position\\_paper\\_COVID-19\\_in\\_prisons.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/UNODC_Position_paper_COVID-19_in_prisons.pdf)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dhe rekomandimet konkrete do të përmirësojnë trajtimin e përshtatshëm dhe dinjitoz të këtyre shtetaseve, edhe në ambientet e institucionit aktualisht akomodues.

Gjetjet e konstatuara dhe rekomandimet konkrete, Ju janë përcjellë institucioneve në nivel epror dhe atyre objekt monitorimi, më konkretisht Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ‘Ali Demi’ (325) dhe Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (Spitali i Burgjeve, Tiranë).



*Përmbajtja e raportit të veçantë të monitorimit është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe e ekspertëve vëzhgues që kanë kontribuar në hartimin e tij. Gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.*